



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 7, datë 31.03.2022

PËR

MIRATIMIN E DOKUMENTIT:
“STUDIM/ANALIZË PËR TEKNOLOGJITË E REJA TË MOBILE BROADBAND NË SHQIPËRI”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 31.03.2022, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme “Për funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, e ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Mbi miratimin e dokumentit: “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”.**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 7 dhe 110, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, (Ligji nr.44/2015);
3. VKM nr. 636, datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për Politikën Spektrale dhe të planit të veprimit”

4. VKM nr.434, datë 03.06.2020 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale broadband 2020-2025.
5. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave”;
6. Rregullore për Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit Publik, miratuar me VKD nr.21, datë 07.12.2021.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti “*Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri*”;
- Relacioni shoqërues i projekt-aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-aktit miratues të dokumentit (Projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në cilësinë e organit rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9918/2008, të tilla si:
 - Nxitjen e investimeve të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm digjital, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e të drejtave të konsumatorit.
 - Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare përmes konkurrencës së drejtë dhe eficiente në treg.
 - Promovimin e asetëve kombëtare, brezave të frekuencave dhe përdorimin efikas të tyre në kuadrin e teknologjive të gjeneratës së ardhshme.
 - Standardizimin e sigurisë së rrjetit dhe besueshmërinë e shërbimeve të komunikimit elektronik përmes ofruesve dhe teknologjive të sigurt.
 - Harmonizimin gjithnjë e më të ngushtë me kërkesat rregullatore dhe të pavarësisë funksionale, duke ndjekur standardet e BE –së dhe të partnerëve kryesorë strategjikë.
2. Në përputhje me detyrimet kontraktore, konsulenti i përzgjedhur nga AKEP (bashkimi i operatorëve ekonomikë “Jones Group International” & “Dynology Corporation” (JGI&DC)), ka hartuar dokumentin “*Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri - Plani Strategjik për 5G*”, dokumenti i cili, është pranuar nga AKEP.
3. Me qëllim marrjen e mendimit nga palët e interesuara, me Vendimin nr. 19 datë 04.11.2021, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit.
4. Konsultimi publik u zhvillua për një periudhë 30 ditore duke filluar nga data 08.11.2021.
5. Për dokumentin në këshillim publik, kanë paraqitur komente dhe sugjerime palët:

- Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) me shkresën nr. 141/26 prot. datë 09.12.2021;
 - Albtelecom sh.a me shkresën nr. 141/25 prot. datë 09.12.2021;
 - One Telecommunications sh.a me shkresën nr. 141/24 prot. datë 09.12.2021;
 - Vodafone Albania sh.a me shkresën nr. 141/27 prot. datë 14.12.2021;
 - Shoqata e investitorëve të huaj në Shqipëri me shkresën nr. 141/23 prot. datë 03.12.2021;
6. Grupi i Punës i ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së bashku me konsulentin kanë administruar komentet dhe sugjerimet e ardhura.

7. Komentet dhe sugjerimet në mënyrë të përmbledhur:

a) Nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës është sugjeruar:

- Të theksohet më shumë fokusi tek përvojat e vendeve të BE-së, për arritjen e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike, politikat e zhvillimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe që lidhen me zhvillimet e pritshme të 5G;
- Të analizohet në mënyrë më të thelluar dhe më të plotë se si mund të realizohet prezantimi i tyre në Shqipëri, hapësira ligjore që duhet krijuar në këtë drejtim, etj.
- Të shoqërohet rekomandimi i konsulentit për krijimin e pesë zonave të licencimit me një analizë të aspekteve pozitive apo negative të procedurës që aktualisht është në përdorim;
- Të thellohet analiza mbi rreth sigurinë e rrjeteve nga pikëpamja teknologjike, dhe nga pikëpamja kibernetike, si edhe mbi zgjidhjet e propozuara për ngritjen/ndërtimin e një rrjeti me fibra optike dhe mbi rekomandimet për lehtësime për zhvillimin e rrjeteve 5G;
- Të jepet një vlerësim i kostos/investimit të nevojshëm për krijimin e laboratorit kërkimor për telekomunikacionet;

b) Nga operatorët celularë jepen vlerësimet, sugjerimet si mëposhtë:

- Mbështesin hartimin e këtij plani strategjik;
- Dokumenti të mos ketë referenca vetëm me përvojat e përfutuara në SHBA, por të përfshijë sa më dendur edhe ato të vendeve të BE-së;
- Procesi ankandit të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës, në funksion të një alokimi sa më efektiv frekuencash;
- Të trajtohet me kujdes propozimi i konsulentit për mbylljen e rrjeteve 2G dhe 3G, përkatësisht brenda 12 dhe 24 muajve nga zbatimi i 4G/5G;
- Të shikohet mundësia e subvencionimit nga Qeveria shqiptare e implementimit të rrjeteve 5G;
- Të merren në kohën e duhur masat konkrete të rekomanduara të tilla si: akte ligjore/nënligjore, apo veprime rregullatore për mbështetjen dhe shpërndarjen e 5G në mënyrë që të merren efektet e pritura ose efektet e vlerësuara në këtë studim;
- Vlerësime që kanë të bëjnë me sasinë e spektrit që do alokohet, shpejtësinë e komunikimeve, kohëzgjatjen e autorizimit, ankandin, mënyrën e pagesave të licencës, etj.

- c) Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri ka paraqitur komentet, sugjerimet si më poshtë:
- Të sigurohet një analizë e detajuar e rrugës së ndjekur në përzgjedhjen e praktikës më efikase në lidhje me alokimin e licencave;
 - Të detajohet analiza ligjore që siguron parandalimin e mbivendosjeve rregullore, si dhe një përshkrim i detajuar i ndryshimeve legjislative të nevojshme për zbatimin e praktikave të rekomanduara;
 - Industria e telekomunikacionit të rregullohet veçmas përmes një Akti të Komunikimeve Elektronike;
 - Të merren parasysh opinionet e palëve të interesuara të tillë si: pjesëmarrësit e tregut, furnitorët, shoqatat përkatëse si dhe ekspertët teknikë;
 - Të ofrohet një bazë mbi të cilën do të kryhet kontrolli i sigurisë;
 - Të ndërmerret çdo veprim i nevojshëm për të siguruar një proces vlerësimi të drejtë, objektiv dhe transparent, të certifikimeve të pajisjeve, që nuk do të dëmtonte drejtpërdrejt ose tërthorazi konkurrencën në këtë sektor;
 - Të hartohet një përkufizim më i qartë i "furnizuesve të besuar" nëpërmjet mbështetjes në parametra teknikë të prekshëm dhe të matshëm;
8. Në përfundim të shqyrtimit të komenteve dhe sugjerimeve dhënë nga palët e interesuara, konsulenti së bashku me AKEP ka zhvilluar takime të veçanta me secilin prej operatorëve celularë. Për shumicën e komenteve dhe sugjerimeve të operatorëve, konsulenti në takime ka dhënë sqarimet e nevojshme.
9. Në fund të muajit dhjetor, Konsulenti ka hartuar dhe dorëzuar dokumentin final në të cilin ka paraqitur edhe ndryshimet përkatëse bazuar edhe në komentet dhe sugjerimet e palëve.
10. Dokumenti “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”, ka përshkruar vlerat dhe përfitimet nga 5G, ku disa prej tyre janë:
- Përfitimet e konsiderueshme ekonomike;
 - Qeverisje Dixhitale për shërbimet publike, përfshirë arsimin, shëndetësinë, menaxhimin e objekteve qeveritare, mbrojtjen, nismat e qytetit inteligjent (*smart cities*);
 - Përfitimet në fushën e shëndetit dhe të mjekësisë;
 - Përfitimet në fusha të ndryshme të industrisë dhe bujqësisë;
 - Përfitimet në transportin publik;
11. Dokumenti përmban disa rekomandime shumë të rëndësishme të tilla si:
- Strukturimin e caktimit të brezave të frekuencave për teknologjinë 5G në funksion të zhdërvjelltësimit të konkurrencës.
 - Zbatimin e një procesi për dhënie të drejtash përdorimi të jetë sa më objektiv dhe transparent, në përfitim të konsumatorëve shqiptarë, ekonomisë shqiptare dhe me qëllim krijimin e një tregu gjithmonë e më konkurrues në Shqipëri.
 - Vlerësimin e efikasitetit të përdorimit aktual të spektrit për të identifikuar sesi përdoret aktualisht spektri.
 - Promovimin e teknologjive të reja që ndikojnë në përdorimin eficient të brezit;
 - Dhënien e zgjidhjeve në favor të tregut nëpërmjet mekanizmave të duhura të alokimit të spektrit;

12. Dokumenti trajton dhe jep rekomandime të qarta edhe për disa çështjet si:

- Mënyrën e trajtimit të spektrit të frekuencave 5G.
- Çështjet teknike dhe teknologjike të rrjeteve 5G.
- Nevojën për sigurinë e rrjeteve 5G.
- Promovimin e 5G përmes fushatave sqaruese dhe ndërgjegjësuese, etj.
- Nevojën e ndryshimeve në legjislacionin parësor dhe rregullator, ndër të cilat përfshihet edhe lehtësimin i procesit të tenderimit/ankandit.
- Nevojën e përcaktimit të kriteve për furnizuesit e besueshëm të teknologjive 5G.

13. Ky plan sjell edhe disa ide të reja novative në aspektin e trajtimit të spektrit të rrjeteve të reja 5G, mënyrën e trajtimit të teknologjive 2G dhe 3G, lejin e përdorimit të teknologjive bashkëkohore në mënyrë të kombinuar (OpenRAN), nevojën e krijimit të një laboratorit kombëtar të telekomit për çertifikimin e pajisjeve të telekomunikacioneve, aplikimin e “network slicing” ku e njëjta sasi spektri mund të përdoret në zona të ndryshme, konceptin e lejitimit të përdorimit të një sasi spektri për rrjete private 5G, adresimin e çështjeve të sigurisë së rrjeteve 4G/5G, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e dokumentit të sipërcituar nisur nga karakteri i tij informues dhe orientues për të gjithë sektorin dhe aktorët institucionalë dhe ekonomikë të përfshirë në të, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri” të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
3. Ngarkohet Grupi i Punës për zbatimin e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako	Xhoana Lilaj